



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të dëgjimit publik me personelin mjekësor, QKMF, QMF të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.08.2019, duke filluar në orën 18:00.

Të pranishëm ishin: Osman Bllaca, përfaqësuese nga ekzekutivi, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, dhe Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Morën pjesë edhe: Dr. Abdyl Pacolli, drejtor i Qendrës së Mjekësisë Urgjente, Dr. Bernard Gegaj, Dr. Rrezart Halili, Kumrije Lokaj zyrtare përgjegjëse për buxhet dhe financa në QMU, Haki Aliu, kryetar i BL-së, dhe Shaip Dushi.

Takimin e hapi dhe e kryesoi Osman Bllaca, përfaqësuesi i ekzekutivit.

Osman Bllaca bëri të ditur se këto diskutime do të jenë rreth hartimit të Kornizës afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme, por në kuadër të kësaj kornize nxjerrim edhe buxheti për vitin 2020. Kërkesat, hallet dhe problemet e juaja me të cilat ballafaqoheni, do t'i inkorporojmë në buxhetin e vitit 2020.

Dr. Abdyl Pacolli, drejtor, tha se në kuadër të planifikimit buxhetor për vitin 2020, në QMU janë paraparë shumë projekte, disa prej tyre janë në zbatim e sipër, e disa në procedurë.

Në QMU tash për tash kemi 6 shtretër, ku vetëm njëri prej tyre është i pajisur me mjetet e nevojshme. Këtë çështje ne e kemi ngritur në kuadër të planifikimit për tri vitet e ardhshme, që të gjithë shtretërit në QMU të jenë të pajisur me pajisjet përcjellëse, sepse janë shumë të rëndësishëm për pacientë.

Çështje tjetër që duhet theksuar, është se në QMU kemi mbi 30 mjekë specialistë dhe realisht është i nevojshëm një funksionalizim i një salle të kirurgjisë së vogël për trajtimin e plagëve të vogla.

Po ashtu, për efikasitet sa më të madh në punën tonë, kemi kërkuar një korse të veçantë të rrugës, kemi kërkuar që aty ku është QMU, të shkolla "Dr. Ali Sokoli", ku ka ngarkesë të

madhe të komunikacionit, sidomos pas orës 16:00, që ta kemi një qasje sa më të shpejtë për ta ndërprerë rrugën, me qëllim që sa më shpejt t'ua ofrojmë ndihmën tonë atyre që kanë nevojë urgjente.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se sivjet kemi miratuar Planin e mobilitetit dhe me këtë plan kemi paraparë korsënë e rrugës për transportin emergjent.

Po ashtu, kemi paraparë edhe një projekt tjetër të një mundësie teknike të zgjidhjes, se në momentin kur ka raste emergjente bllokohet komunikacioni dhe bëhet një kalim prej anës së drejtimit kahor lart në drejtimin tjetër, që mundësohet dalja emergjente në anën tjetër, në drejtim të rrethrotullimit, pastaj në drejtim të qendrës, që këtë projekt mund ta realizojmë sivjet.

Dr. Bujar Gashi, drejtor, lidhur me çështjen e aparaturave dhe pajisjes së shtretërve, tha se disa janë në procedurë, dhe pritet që shpejt të furnizohemi me aparaturë dhe pajisje të tjera mjekësore. Me këto dy projekte të mëdha nuk do të pajiset vetëm QMU, por edhe të gjitha QMF-të.

Po ashtu, brenda këtij viti shpresojmë se do të funksionalizohet edhe salla e mikro - kirurgjisë, e cila është shumë e nevojshme.

Dr. Bernard Gegaj, tha se është më se i nevojshëm një renovim në Poliklinikën Stomatologjike, një renovim në daljen e pasme të objektit, ku duhet të intervenohet në ventilimin e laboratorit dentar. Po ashtu, e shoh të nevojshëm dislokimin e kompresorëve, jashtë ordinancave, dhe të vendosen në objekte të posaçme, vendosjen e sistemit të kamerave, si dhe kutia e hyrje-daljeve. Gjithashtu, kemi nevojë edhe për aparaturë tjetër plotësuese, për disa autoklava të tjera.

Dr. Bujar Gashi theksoi se sa i përket renovimit të objektit në programin e BERZH-it për eficiencën, besoj që është edhe Poliklinika e Stomatologjisë. Po ashtu, në projekt është paraparë edhe ngjyrosja e kësaj poliklinike. Autoklavat janë pajisjet e projektit tenderues, i cili është në proces dhe besoj që do të përfundojë javën e ardhshme. Presim që brenda këtij viti të furnizoheni. Ndërsa për lëvizjet e kompresorëve, do të shihet mundësia se me çfarë projekti do të përfundojë kjo, sepse nuk është as furnizim, as blerje, as renovim, duhet gjetur një mënyrë për shkak të kodeve buxhetore.

Dr. Rrezart Halili shtroi pyetjen se çka është duke bërë Komuna e Prishtinës për mbrojtjen e buxhetit të Qendrës Kryesore Familjare në Prishtinë, duke pasur parasysh se ne japim shërbime edhe për 5 komuna të tjera, dhe në fund ne ngelim pa iu ofruar shërbime qytetarëve të Prishtinës. Gjithmonë jemi të cunguar në planifikimin e materialeve, sidomos për laborator dhe rëntgen. Në të njëjtën kohë kemi mungesë të stafit. Nëse planifikohet me u hapur edhe QMF në lagjen "Veterniku", atëherë ka me qenë një sfidë e re e planifikimit të shërbimeve. Nëse vazhdojmë me këtë trend, kërkojmë rritje të pagave dhe të stafit, në mënyrë që të kemi cilësi të qëndrueshme në shërbime.

Njëherësh kërkoj të dijë se a është duke e shfrytëzuar Komuna e Prishtinës grantin e kryeqytetit dhe a është ndarë diçka për shëndetësi nga ai buxhet.

Osman Bllaca, sa i përket grantit për shëndetësi, tha se çdoherë është sensibilizuar si problem edhe në nivelin qeveritar, që ne iu japim shërbime më shumë sesa që është numri i regjistruar në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, që thotë se Prishtina i ka 197,000 banorë.

Ne i kemi bërë shifrat e sakta edhe për nxënësit e klasave të para, ku e dimë se sa qytetarë mundemi me i pasur me lindjen e natalitetit. Kemi edhe shumë mekanizma të tjerë me të cilët i dimë që kemi banorë më shumë se sa ai numër që doli nga regjistrimi i popullsisë.

Granti i kryeqytetit është 10 milionë e 800,000 €, që është ndarë edhe në kuadër të tyre, është viti i par që e kemi përfituar këtë grant. Prej tij janë ndarë 5 milionë euro për investime kapitale, sepse buxheti ndahet në 5 kategori: “paga dhe mëditje”, “mallra dhe shërbime”, “investime kapitale”, “subvencione dhe komunal”. Ne si Komunë e kemi mundësinë që me marrë vendime karshi veprimtarisë që neve na takon. Unë kam qenë pjesë e ndryshimit që kemi tentuar me bërë, me qellim që të shtojmë çmimin e shërbimeve për 3 fish më të lartë për qytetarët që nuk janë banorë të Prishtinës. Këtë Vendim e kemi sjellë në Kuvendin e Komunës, Kuvendi e ka hedhur poshtë, pra nuk e ka miratuar.

Dr. Rrezart Halili shprehu mendimin se duhet shkuar edhe në bazë të performacave të drejtorive komunale. Nëse Drejtoria e Shëndetësisë ka performacë të mirë, a mundet kjo me u shpërblyer prej grantit, apo janë të parapara shumë më herët në bazë të stimulimit.

Osman Bllaca bëri të ditur se për hartimin e buxhetit komunal përgjegjës është Kryetari. Janë 16 drejtori në Komunën e Prishtinës, ku e bëjnë kërkesën, p.sh. vetëm për këtë vit, për investime kapitale na kanë ardhur diku 51 milionë prej këtyre 16 drejtorëve. Me tavanet buxhetore që janë tash, është e pamundur me pasur buxhet më të lartë një drejtori sesa drejtoritë tjera.

Për shtimin e stafit është problem, për shkak se kërkohet me u shtuar pagat, shtimin e numrit të ambulancave, është problem sidomos te punëtorët. Edhe në nivel të Komunës kemi mungesë të punëtoreve, por nuk na lejohet rritja e numrit të punëtorëve, për shkak se është numër shumë i lartë i të punësuarve.

Dr. Avdyll Pacolli u shpreh se dr. Rrezart Halili me të drejtë e ngriti çështjen e problemit të banorëve jo rezidentë të komunës së Prishtinës.

Mbi këtë bazë, ne si QMU dhe QKMF, kryejmë shërbime të shumta, ballafaqohemi me shumë probleme dhe jam këtu për me bërë më të mirën për taksapaguesin prishtinas. Sipas protokollit të mjekut të shërbimit familjar, për me zbatuar konceptin e Mjekësisë familjare, mjeku familjar duhet të jetë në punë realisht prej orës 8-16 dhe mandej futen në shërbimet te urgjencat brenda QMF-ve. Kryerja e shërbimeve të shumta për qytetarët të cilët nuk janë banorë të Prishtinës e mbingarkon procesin, mjeku familjar nuk mund t’ua kushtoj kohën e duhur banorëve të zonës.

U tha që buxhetet planifikohen nga poshtë-lart, dhe pajtohem me këtë, por pse të mos favorizohet kushtimisht shërbimi, jo Drejtoria e Shëndetësisë. Neve po na ikin me qindra mijëra shërbime, shkojnë në Maqedoni e në vende tjera të rajonit!

Kumrije Lokaj, zyrtare përgjegjëse për buxhet dhe financa në QMU, theksoi se ka dy çështje që i shqetësojnë punëtorët e urgjencës. E para, është çështja e sigurisë, të cilën nuk e gëzojnë punëtorët. Tash e 17 vjet bëjë planifikim për këtë çështje dhe asnjë herë nuk ka arritur të realizohet kjo. Kam biseduar edhe me Ministrinë e Financave, ata më kanë thënë se kjo duhet të kalojë përmes Kuvendit dhe Kuvendi pastaj të kërkojë buxhet shtesë.

Çështja tjetër është ndryshimi i vendimit të tarifave për udhëtime zyrtare, që ne po kemi

probleme, ka tarifa për udhëtimin zyrtar në Maqedoni dhe Shqipëri, ka qenë 41.80 €, tani është zvogëluar dhe është bërë 26 €. Dihet që transporti i pacientëve mund të jetë në mesnatë, varësisht nga rasti, dhe këta nuk kanë mundësi të ushqehen ose të marrin fatura. Kjo është një çështje shumë problematike me të cilën po ballafaqohemi. Udhëtimi zyrtar dallon nga transporti i pacientit, andaj kërkoj që të bëhet një zgjidhje.

Dr. Bujar Gashi tha se kemi diskutuar edhe me herët lidhur me këtë çështje. Vendimi për rregullimin e mëditjeve është në nivel vendi, jo në nivel komune, dhe nuk mund të ndryshojë asgjë.

Haki Aliu, kryetar i BL-së, paraqiti shqetësimin e banorëve të rrugës “Tomori”, të cilëve iu refuzohen shërbimet shëndetësore në QMF-në në rrugën “Xhemajl Ibishi”, por atyre u kërkohet që vizitat t’i kryejnë në lagjen “Kodra e Trimave”, diku 5 kilometra më larg. Ai kërkoi që brenda mundësive banorët e rrugëve: “Nexhmi Llumca”, “Tomori” dhe “Sheshi i Arbrit”, t’i kryejnë shërbimet shëndetësore në QMF-në afër stadiumit të Flamurtarit.

Dr. Bujar Gashi theksoi se ndarja bëhet në bazë të numrit të banorëve. Kemi probleme edhe me zonat kufitare, edhe me rajonin me Maqedoninë dhe Shqipërinë, ku fshatrat e ndryshme e kanë një fshat më afër që ka ambulancë shëndetësore, sesa në vendin e tyre. Kjo kërkesë do të shikohet në vazhdim, nëse do të ketë një reformulim të zoonimit do ta marrim parasysh. Sa i përket urgjencave për pacientët e shtrirë në shtrat, janë ekipet e emergjencave, që nuk kanë zoonim, kufizim për me ofruar shërbimin shëndetësorë emergjent.

Dr. Rrezart Halili tha se në të ardhmen, nëse mendojmë me zbatuar konceptin e Mjekësisë familjare si në Evropë, secili do ta ketë mjekun e vetë familjar. Në Prishtinë 24 orë mundet me ardhur pacienti me një arsye shumë të thjeshtë. Nuk po e them që nuk keni kërkesa të ndryshme, por ne përballemi vetëm gjatë ndërrimit të natës me 80 pacientë, ku 3% e tyre kanë nevojë për shërbim në ndërrimin e natës.

Debati përfundoi në orën 19:00.